



THIRRJE PËR APLIKIM NË PROGRAMIN “NGRITJA E KAPACITETEVE PËR NËPUNËSIT CIVILË TË ADMINISTRATËS PUBLIKE, PËRFSHIRË TRAJNIMET/PRAKTIKAT DHE VIZITAT STUDIMORE NË ADMINISTRATAT E VENDEVE ANËTARE TË BE-SË (QELIZAT E REJA)”.

A/HYRJE

Projekti ‘Qelizat e Reja/Young cells’ i financuar nga Bashkimi Evropian nën IPA II 2020, synon t’i japë mundësinë 25 nëpunësve civilë të administratës publike shqiptare të marrin pjesë në një program zhvillues për rritjen e kapaciteteve të tyre. Në këtë program përfshihen trajnime praktike, seminare dhe workshop-e, vizita studimore dhe praktika pune në shkollat dhe administratat publike të 5 vendeve anëtare të Bashkimit Evropian (Francë, Itali, Gjermani, Greqi dhe Kroaci). Programi do të mbështesë Qeverinë Shqiptare në reformën e shërbimit civil dhe do të kontribuojë në zhvillimin e mëtejshëm të një administrate publike eficiente, efektive dhe transparente në Shqipëri.

Programi do të zbatohet nga Instituti Kombëtar Francez i Shërbimit Publik (French National Institute of Public Service/INSP) dhe partnerët: Universiteti i Shkencave Administrative të Aplikuara në Kehl (Gjermani); Universiteti i Bolonjës; rajonin Emilia-Romagna (Itali) dhe dy partnerët shoqëruues Shkolla e Administratës Publike e Kroacisë dhe Greqisë në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike dhe Shkollën Shqiptare të Administratës Publike.

Ky program do të nisë në muajin shtator 2023 dhe do të përfundojë në fund të muajit prill 2024.

B/ KUSH MUND TË APLIKOJË DHE SI?

1) Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet dhe kriteret e posaçme si vijon:

- ✓ Të jenë shtetas shqiptar;
- ✓ Të jenë nëpunës civilë të konfirmuar;
- ✓ Të jenë aktualisht të punësuar në institucione të shërbimit civil në administratën shtetërore, institucione të pavarura dhe në njësitë e qeverisjes vendore;
- ✓ Të jenë nëpunës civilë që i përkasin nivelit të ulët drejtues (kategoria e pagës III-a, III-a/1) dhe nivelit ekzekutiv (kategoria e pagës III-b, IV-a, IV-b dhe IV-c);
- ✓ Të kenë nga 3 deri në 8 vite eksperiencë pune në administratën publike, deri në datën e aplikimit (duke përfshirë dhe periudhën e provës për nëpunësin civil);
- ✓ Të mos kenë përfituar nga skema të tilla në të shkuarën;
- ✓ Të plotësojnë dhe të dërgojnë dosjen e aplikimit në adresën e e-mail: youngcells@insp.gouv.fr deri ditën e martë, datë **6 qershor 2023 ora 23:59**



2) Dosja e aplikimit duhet të përmbajë:

- Letrën e motivimit në gjuhën angleze e cila përfshin informacionin si vijon:
 - Cila është arsyeja dhe motivimi juaj për të aplikuar në këtë program?
 - Si lidhet eksperiencia juaj e punës me objektivat kyçe të këtij programi (referojuni Aneksit 1)
 - Çfarë përfitimesh prisni nga programi/trajnimi (për veten tuaj personalisht si dhe për institucionin ku ju punoni)?
 - Si lidhet ky trajnim me projektet tuaja për të avancuar në karrierë?
- Aktin e konfirmimit si nëpunës civil dhe një kopje të librezës së punës (ku vërtetohet eksperiencia e punës 3-8 vite, në administratën publike)
- Jetëshkrimin (CV) në gjuhën angleze në formatin Europass sipas link-ut:
<https://europa.eu/europass/en/create-europass-cv>

3) Kërkesa shtesë të kritereve kualifikuese

- ✓ Njohja e gjuhës angleze (e detyrueshme) së paku niveli C1 e vlerësuar sipas kuadrit:
<https://europa.eu/europass/en/common-european-framework-reference-language-skills>
- ✓ Njohja e gjuhëve frënge, gjermane, italiane, kroate dhe greke (opsionale) së paku niveli B1;
- ✓ Të siguroheni që keni njoftuar njësinë e Burimeve Njerëzore dhe drejtuesit në nivel hierarkik, mbi aplikimin tuaj, datat dhe përmbajtjen e programit;
- ✓ Në rast përzgjedhje si pjesëmarrës në program, kandidatit të kualifikuar do t'i kërkohet të firmosë një letër angazhimi. Letra e angazhimit do të përfshijë pjesëmarrjen në të gjitha aktivitetet e programit dhe në të do të përcaktohet se nëpunësi civil do të vazhdojë të shërbejë në administratën publike (përfshirë institucionet e pavarura dhe ato të nivelit vendor) për së paku 2 vite pas përfundimit të këtij programi.

C/ ORGANIZIMI I PROCEDURËS SË PËRZGJEDHJES

Përzgjedhja e kandidatëve do të zhvillohet në tre faza:

1. **Verifikimi i përmbushjes së kritereve:** shqyrtimi i aplikimit në lidhje me përmbushjen e kushteve dhe kritereve të posaçme.
2. **Përzgjedhja paraprake:** kjo fazë do të konsistojë në testimin me shkrim për të kontrolluar aftësinë në gjuhën angleze, gjithashtu edhe në gjuhët e tjera opsionale (nëse ka). Testimi me shkrim do të bazohet në sintezën dhe analizën e dokumentave në gjuhën angleze (dhe të gjuhës opsionale nëse ka), mbi tematika në lidhje me administratën publike dhe në kontekstin aktual të procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Testimi me shkrim do të zgjasë dy orë për pjesën e gjuhës angleze (i njëjtë për të gjithë kandidatët). Kandidatët që do të bëjnë testimin me shkrim në gjuhën kroate, gjermane, greke, frënge ose italiane (gjuhët opsionale) do të qëndrojnë edhe për dy orë të tjera (pas një pushimi prej së paku 30 minutash).

Të gjithë kandidatët që kanë arritur të kalojnë pragun që i përket nivelit C1 të gjuhës angleze, do të ftohen për hapin tjetër të përzgjedhjes (intervistën me gojë). Pikët e marra për gjuhën opsionale (nëse ka) do t'iu komunikohen anëtarëve të jurisë për t'u marrë parasysh gjatë vendimit final, si një vlerë e shtuar për një praktikë pune/*internship* të suksesshme, në një nga 5 vendet anëtare të BE (pikët për gjuhën opsionale janë deri në 20 pikë).

3. **Intervista me gojë:** të gjithë kandidatët e përzgjedhur nga faza paraprake (shortlist-uar) do të ftohen për një intervistë individuale, për tu pranuar në program, (kohëzgjatja e intervistës 45 minuta).

D/ AFATET E THIRRJES

6 qershor 2023 (23:59 ora lokale): afati për dorëzimin e dosjes së aplikimit në adresën e e-mail: youngcells@insp.gouv.fr

19 qershor 2023: testimi me shkrim i gjuhës së huaj

28 qershor 2023: publikimi i listës së kandidatëve të përzgjedhur (*shortlist-uar*), si dhe njoftimi i secilit prej tyre për zhvillimin e intervistës me gojë.

3-12 korrik 2023: zhvillimi i intervistave me gojë

21 korrik 2023: publikimi i listës përfundimtare të pjesëmarrësve, në faqen zyrtare web <https://ycsalbania.eu/> të projektit 'Young cells' dhe në faqen zyrtare të DAP www.dap.gov.al

Të tjera: Për tu njohur më shumë me përmbajtjen e këtij programi referojuni:

1. Aneksit 1 ku do të gjeni 'objektivat kryesore të projektit' dhe
2. Aneksit 2 ku listohen aktivitetet të cilat do të zhvillohen në kuadër të programit

Për çdo paqartësi apo informacion shtesë mund të drejtoheni me kërkesë për informacion në adresën: youngcells@insp.gouv.fr